

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 19.1.2022**

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS  
SHTETËRORE DHE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2022**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7 dhe nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJMË:**

**I. Matura Shtetërore**

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2022, për arsimin e mesëm të lartë të jenë:

a) provime të detyruara: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe gjuhë e huaj;

b) një provim me zgjedhje.

2. Provime të detyruara

a) Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, gjuhë e huaj) për të gjithë maturantët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

b) Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

c) Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht dhe turqisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

3. Provimi me zgjedhje

a) lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Kimi;

Fizikë;

Biologji;

Histori;

Gjeografi;

Qytetari dhe psikologji;

Filozofi dhe sociologji;

Ekonomi;

Histori Arti;

Histori Muzike;

Histori Baleti;

b) programet orientuese të lëndëve me zgjedhje, të jenë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z;

c) programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje;

d) maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

5. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapin atë që të pajisen me diplomë.

6. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2021 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

7. Datat për provimet e Maturës Shtetërore 2022 të jenë:

- a) Gjuhë e huaj 9 qershor 2022;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi 11 qershor 2022;
- c) Matematikë 17 qershor 2022;
- d) Provimi me zgjedhje 24 qershor 2022.

8. Provimet e Maturës Shtetërore 2022 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

9. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2022 hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

10. Testi për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2022 vlerësohet me 60 pikë maksimale.

11. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2022, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

12. Zyrat vendore arsimore parauniversitare (ZVAP-të) pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2021–2022 i pasqyrojnë ato në portalin e Maturës Shtetërore *online*, sipas udhëzimit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

13. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore, sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

14. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*lingua e literatura italiana*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatën kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 9 qershor 2022 dhe zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3), për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në Memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 1 qershor 2022 para një komisioni të ngritur nga palët.

15. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (*DELFB2 scolaire*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 25 maj 2022, në shkollat përkatëse.

16. Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2022 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2022.

17. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2022 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

## II. Matura Shtetërore Profesionale

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2022, për shkollat e mesme profesionale, të jenë:

Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar”, sipas kualifikimit profesional që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.

2. Datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2022, të jenë:

- a) Gjuhë e huaj 9 qershor 2022;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi 11 qershor 2022;
- c) Matematikë 17 qershor 2022;
- d) Teori Profesionale e Integruar 24 qershor 2022.

3. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

4. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021) që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

5. Lista e provimeve të detyruara të Teorisë Profesionale të Integruar, sipas kualifikimit profesional që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale, është:

<b>Nr.</b>	<b><i>Kualifikimi profesional</i></b>
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut
26	Zhvillim <i>website</i>
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike <i>software</i> -sh ( <i>Hermann Gmeiner</i> )
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanik (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot-GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji Bujqësore

6. Provimet e detyruara “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj e parë”, dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

7. Provimet e detyruara të Teorisë Profesionale të Integruar, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara në faqet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

8. Kandidati i cili rezulton mbetës në të paktën një të provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

9. Kandidati që në Maturën Shtetërore të viteve 2013–2016:

a) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje;

b) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje;

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, të cilat nuk përfshihen Teoria Profesionale e Integruar, duhet të japë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

10. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provimin e Teorisë Profesionale të Integruar, ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshëm për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

### **III. Dispozitat e fundit**

1. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2022 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit (MAS), zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Sekretari i Përgjithshëm i MAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat arsimore vendore parauniversitare, Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Aftësimin Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

**Evis Kushi**

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Delina Ibrahimaj**